



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 13

Rrogozhinë, më 20.11.2024 ora 13 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.4810.Prot datë 15.11.2024, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.12, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 30.10.2024.
- 3- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve Bashkia Rrogozhinë ”. *(Pikë e mbartur nga mbledhja e datës 30.10.2024).*
- 6- Raport i auditimit të brendshëm mbi punën e bërë dhe problematikat e evidentuara në Bashkinë Rrogozhinë.
- 7- Të ndryshme.
 - *Informacion për Udhëzimin nr.143, datë 19.07.2024 nga Komisioni Qëndror i Statusit “Dëshmor i Atdheut”.*
 - *Të tjera.*

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Merilin Saraçi, Saimir Cani, Isa Halili, Sokol Gosa, Mijat Daja, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Erind Tosku, Mukades Gixhari, Erind Tosku.

Mungojnë :



Lije Dedej, Besnike Coraj, Lulzim Hasa, Shpati Kolgega.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkyetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
4. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
5. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ledian Hasani - Drejtor i mirëqënies dhe kujdesit social.
7. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
8. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
9. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
10. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
11. Lorenc Boriçi - Kryeinspektor i Policisë Bashkiake
12. Posta e policisë së rendit Rrogozhinë - Përfaqësuar nga efektivet e policisë z. Haki Met-hasa, z. Astrit Thartori dhe z. Qerim Saliu.
13. Gezim Sina - Kryeinspektor i IMTV-së.
14. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
15. Sidorela Aliu - Specialiste IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 13- Këshilltarë. Këshilltarët z. Sokol Gosa, z. Erind Tosku, z. Altin Tosku i bashkohen në vijim mbledhjes duke e çuar në 16 numrin e anëtarëve të pranishëm në sallë.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përshëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm



mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje Këshilltarët : z. Hekuran Xhani, znj. Silvana Aliu, z. Indrit Dedej, z. Saimir Cani, z. Isa Halili, z. Mitat Daja, znj. Gezime Met-hasani, znj. Alime Hoxha, z. Enver Memolla, znj. Fatmira Thartori, z. Renato Kalemi, z. Erind Tosku dhe Mukades Gixhari. Gjithsej jemi 13- Këshilltarë.

-Lexojmë konfirmimin ligjor të ardhur për vendimet e këshillit bashkiak me karakter normativ të datës 30.10.2024 të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Vendim nr .51, datë 30.10.2024 “Për miratimin e Planit Social të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025-2028”.

Konfirmohet në parim referuar ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Vendim nr .53, datë 30.10.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.38, datë 27.12.2024 për buxhetin e bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024”.

Nuk konfirmohet referuar nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar pasi nuk jemi në rastin e një rishpërndarje fondi ndërmjet programesh, por miratim i një fondi të parashikuar në buxhetin e vitit 2024”.

Vendim nr .54, datë 30.10.2024 “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkuar midis Bashkisë Rrogozhinë dhe ASHK-së”.

Nuk konfirmohet pasi nuk është kompetencë e këshillit bashkiak miratimi i marrëveshjeve të nënshkuara, por është detyrë e kryetarit të bashkisë, kjo referuar në nenin 9 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përcaktuar dhe në nenin 10 të kësaj marrëveshje. Me respekt, Prefekti Afrim Qendro.

Tani vazhdojmë me vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 30.10.2024 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr .49, datë 30.10.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%” .

Vendim nr .50, datë 30.10.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.

Vendim nr .52, datë 30.10.2024 “Për miratimin e kërkesës së z. Haziz Jashar Kashari për ndihmë të menjëhershme financiare”.

- Të nderuar këshilltarë ju bëj me dije që sot kemi njoftuar Përfaqësues nga Posta e Policisë Rrogozhinë, Zyra Vendore Arsimore Rrogozhinë, Drejtoria e Arsimit në Bashki, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social në Bashki, Policia Bashkiake për të shqyrtuar së bashku masat që do merren për parandalimin e dhunës mes adoleshentëve në Bashkinë Rrogozhinë në ambientet e shkollës por dhe jashtë saj. Besoj të gjithë jeni dakord për përfshirjen në rendin e ditës të kësaj



çështjeje, pasi u kërkua po nga ju? Dmth jeni dakord të nderuar këshilltarë ta përfshijmë?
Miratohet.

- Gjithashtu para se të kalojmë në rendin e ditës, ju bëj me dije për një çështje të cilën e diskutuam dhe në mbledhjen e mëparshme, për krijimin e një grupit “Të bashkuar” nga 4 Këshilltarë: z. Mitat Daja, z. Saimir Cani. z. Isa Halili dhe z. Sokol Gosa. Pas plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm grupi konsiderohet i krijuar.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Jeni dakord me rendin e ditës? Pro, kundër, abstenim?
z. Indrit, znj. Silvana? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 13-vota pro, pika e parë e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.12, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 30.10.2024. Jeni dakord për miratimin e këtij procesverbali? Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 13-vota pro, pika e dytë e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën 3, Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani. Përshëndetje z. Ledian!

Ledian Hasani . Kemi 17 familje me një fond prej 78 mijë lekësh.

Mukades Gixhari . Dokumentacionin e keni të gjithë përpara. Ndonjë pyetje për z. Ledian sugjerim? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 13-vota pro, pika e tretë e rendit të ditës.

Vendim nr.55. Miratohet me 13-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.4783.Prot datë 14.11.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, si dhe Relacioni Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4783/1.Prot datë 14.11.2024.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4, Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.



Vazhdojmë po me drejtorin e mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian.

Ledian Hasani . Janë gjithsej 19 familje dhe fondi është rreth 80 mijë lekë të reja.

-Mbledhjes i bashkohet këshilltari z. Sokol Gosa në minutën e 7 të zhvillimit të saj.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje për z. Ledian, sugjerim?

Isa Halili . E komunikova dhe personalisht me Ledianin për sa i përket mbikqyrjes të gjithë territorit të bashkisë Rrogozhinë por dhe në Njësinë Administrative të Sinaballaj ka njerëz që kanë probleme ekonomike. Referuar shifrës me të cilën janë ndarë këto 17 familje duket një shifër shumë qesharake por megjithatë për sa kohë jetojmë në kushte të vështira sado qoftë e ndihmon kjo nuk është se e kuptoj qartë pozicionin e Ledianit se ato janë paratë ato janë paratë e akumuluar nga bashkia ato janë mundësitë. Mendoj që të ketë një lloj zgjerimi në të gjithë sepse besoj dhe sipas konstatimeve që unë kam, ka dhe shumë familje të tjera të cilët nevojiten të kenë ndihmë dhe përkrahje sociale.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Pyetje tjetër? E hedhim në votim.Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 14-vota pro, pika e katërt e rendit të ditës.

Vendim nr.56. Miratohet me 13-vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.4784.Prot datë 14.11.2024 ,“Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacioni Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4784/1.Prot datë 14.11.2024.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Ledian. Vazhdojmë me pikën 5, Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve Bashkia Rrogozhinë ”. Është pikë e mbartur nga mbledhja e datës 30.10.2024. Do të na relatojë drejtoresha e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik znj. Marsida Thartori dhe drejtori i financës z. Rezart Vogli. Mbledhjes ju bashkua dhe z. Sokol Gosa.

-I bashkohet mbledhjes këshilltarja znjsh. Merilin Saraçi në minutën e 10 të zhvillimit të saj.

Marsida Thartori . Përhëndetje! Kjo pikë është një pikë e mbartur dhe nga mbledhja e kaluar ne e diskutuam pak por mund ta rrelatojmë nga e para për të gjithë ata që nuk kanë qenë. plani i



menaxhimit të mbetjeve është një plan vendor i cili i shkon për shtat planit të menaxhimit të mbetjeve kombëtar. Është një plan që është hartuar nga Bashkia Rrogozhinë në mbështetje me Bashkitë e Forta që ka suportuar në pjesën më të madhe të bashkive. Është ndërtuar mbi bazë ligjore ecën për krahu tre skenarëve është skenari bazë në të cilin jemi, është skenari i parë dhe skenari i dytë. Skenarët parashikojnë që të ndërtohet një stacion transferimi për depozitimin e mbetjeve dhe të bëhet ndarja në burim. Planin besoj e keni që të gjithë.

Indrit Dedej . Si je me rehabilitimin e plehrave, e ke sot këtë (tregon foto nga celulari)? Nëse ti i ke bërë rehabilitim atyre plehrave që janë ekzistuese ne jemi dakord me planin që duan të menaxhojnë ato nga vijnë ato projektet tua. Ik bëj një xhiro sepse ti je dhe punonjëse e bashkisë, bëj një xhiro për qark dhe hajde na sill ato planet e rehabilitimit kjo është gjëndja. Këto shkojnë direkt në Vilë Bashtovë.

Silvana Aliu . Ka mbi 10 ditë që nuk merren plehrat në qytet.

Indrit Dedej . Kjo është për t'i treguar ju në radhë të parë atyre Tiransve që ne nuk jemi të gatshëm për rehabilitimin e këtyre e jo më të vijnë të sjellin përrallat e tyre për të tërhequr fonde ato ku e di unë çfarë duan me bërë. Ne nuk jemi kurrë kundra por rehabilito njëherë këto që ke këtu pastaj...

Isa Halili . Problematika e plehrave në bashkinë tonë besoj që duhet të biem të gjithë dakord që është problematika më e madhe që ka qyteti jonë. Jemi të gjithë koshientë dhe këtu ka kush më shumë e kush më pak po kurrë kurrë nuk ka qenë qyteti në këtë lloj situatë alarmante në të cilën ndodhet. E di ka pasur problematika por kudo që shkon jo vetëm në qendër të qytetit por edhe në njësitë administrative situata është jashtë kontrollit. Unë kam depozituar disa foto në një diskutim që kemi parë tek këshilli tek grupi jonë i këshillit por kam dhe disa të tjera të cilët tregojnë një lloj situatë të papërgjegjshme nga njerëzit këtu nuk e di dhe nuk dua të paragjykoj askënd për punën që bën por populli thotë “fshati që duket nuk ka nevojë për kallauz” situata është aty, besoj të gjithë e shohin ajo që më shqetëson më tepër është fakti që pse nuk kemi atë nervin për të reaguar për të treguar qoftë edhe këta njerëzit këtu në këtë institucion që punojnë me njëri tjetrin sepse tek e fundit është problem për të gjithë ne që jetojmë këtu. Isha krejt rastësisht tek zona e shinave të trenit mbi qytet dhe aty kishte fëmijë pa fund që luanin mbi plehra. Një situatë unë nuk e di sinqerisht këtu pjesa më e madhe këtu janë prindër se si e quajnë një gjë krejt të zakonitë këtë gjë dhe këtu ndër të tjera është një autoironi që e bëjnë këta që na udhëheqin ne që na vijnë me plane masash që marrin për mbetjet. Ndërkohë situata e mbetjeve është katastrofike, kurrë nuk ka qenë ky qytet të paktën në 30 vite demokraci si është situata alarmante me plehrat që është aktualisht dhe nuk është një problem ky po themi i ditëve të fundit



sepse ka qenë para pas po thmi dy vitet e fundit në nivele alarmante. Ishte gjatë periudhës së verës në zona që ne i quajmë tradicionalisht në zona për sa i përket turizmit dhe tani është gjithandej. Mungojnë koshat e plehrave që janë gjëja më bazike nuk duhet të diskutosh për këto gjëra në vitin 2024. E frikshme pastaj për të mos folur për situatën menaxhimin që është katastrofal.

Mukades Gixhari . Ndjesë doja të ju thoja që për një projektvendim fjala do merret vetëm njëherë nga secili këshilltar 3 minuta, dy herë për të njëjtën çështje nuk do ta marrë fjalën njeri ta bëjmë si rregull për mbarëvajtjen e mbledhjes.

Mitat Daja . Unë do flas më pak se tre minuta të jesh e sigurtë. Duke marrë parasysh se ju jeni mësuar të na i sillni kështu projektvendime pastaj këto bëhen vendime miratime dhe nuk duam të bëjmë tani atë të vështirin që nuk duam të miratojmë sepse edhe ne nuk kemi dëshirë ti kemi plehurat mbi kokë. Por se ju keni caktuar dhe një taksë për plehurat apo jo? Tek paketa fiskale që kam parë ju keni caktuar dhe një taksë ajo taksa mblidhet dhe kur mblidhet taksa unë e kam paguar taksën e shtëpisë psh se do dali do thuash që nuk kam paguar taksën e kam paguar dhe të dyqanit dhe të shtëpisë. Ideja është që kur mblidhet kjo taksë unë dua shërbim, kur shoh plehurat mos flasim për se Saimiri ka një foto të Gërmenjit të tjerët kanë në Spille apo Sinaballaj është e paimagjinueshme por kur i shoh dhe tek shkolla 9-vjeçare e në mes të pazarit ato koshat e rrënuar që nuk e di... ajo taksa ime më duket sikur ma keni vjedhur. Plus që kur të vijë koha e paketës do flasim dhe për paketën se ka ca gjëra që nuk janë por po flasim për plehurat. Unë mendoj që këtë lloj projektvendimi që ju keni sjell ne nuk kemi as pse ta diskutojmë deri kur ju të përmirësoheni. Përmirësohuni dhe pastaj hajde ta diskutojmë se ne nuk jemi ata që nuk duam të bëjmë ndarjen e mbetjeve siç keni sjell ju skenari 1, skenari 2 dhe shuma është goxha nuk është një shumë e thjeshtë flitet më shumë se 1 milion euro sa është ajo shuma nuk e mbaj mend fiks. Por një shumë, shumë e madhe dakord jemi që të bëhen ndarje e gjithë këto tjerat por jo të na e sillni me situatën që kemi është e pamend dhe e pavend që të diskutojmë për plehurat kur plherat ne po na bien në kokë. Nuk pastrohet koshat rrijnë për faqe të zeze është turp t'i shikosh për dezinfektim nuk bëhet fjalë skam parë ndonjëherë dizinfektim. Mbaj mend që të mos kaloj dhe atë tre minutëshin që tha zysha, para disa viteve u hidhte ndonjë gëlqere tani nuk e mbaj mend kur ka ndodh kjo gjë. Prandaj ky është mendimi im personal mendoj që kjo as mos diskutohet as mos flitet më fare se nuk ka vlerë me u folur për këtë punë është e pallogjikshme që me folur, secili ka mendimin e vet ky është për këtë projektvendim që bëni ju.

Silvana Aliu . Unë e kam thënë përderisa nuk ka shërbim qytetarët nuk janë të detyruar të paguajnë taksën. Ju si bashki keni marrë ndonjë masë kundrejt kësaj firme për mosmbledhjen e mbeturinave?



Mitat Daja . Po por duhet të kishte ardhur dhe drejtoresha e shërbimeve këtu të na sqaronte problemin që ka. Se më fal Silvana që po të ndërpres fjalën, ka një drejtoreshë shërbimesh që duhet të vijë e të na thotë cili është problemi që plehrat po na zenë derën e shtëpisë?

Silvana Aliu . Përgjigja është dhënë qartë e bukur personi nuk na përgjigjet nuk na hap telefonin.

Marsida Thartori . Unë thjeshtë erdha të relatoj për planin e menaxhimit të mbetjeve që është një plan që i shkon për shtat planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve, direktivave të Bashkimit Europian është një plan që përfshin 5 vitet e ardhshme. Është bërë një analizë kosto mbi tarifimin që aktualisht bashkia Rrogozhinë ka. Dhe ka dalë në konkluzionin që ne aktualisht mbulojmë vetëm 13% të kostos së pastrimit, këtë përfshin plani për më tepër përgjigje.

Erind Tosku . Mund ta shohim dhe në një moment të dytë se nuk është me afat kohe por për mbledhjen e radhës përgjegjësi për mbetjet apo për shërbimet të vijë të japë një farë sqarimi sepse është alarmante nuk është shaka se mbartin shumë gjëra mbrapa nuk është çështje etike por varet nga ana ekonomike ana sociale higjena etj.

-Fjalën e merr këshilltarja znj. Fatmira Thartori dhe më pas z. Renato Kalemi por për shkak të shkëputjes së mikrofonit të parë, pranë z. Mitat Daja fjala e tyre nuk dëgjohet).

Rezart Vogli . Përsëritet të gjithëve! Në lidhje me planin e menaxhimit të mbetjeve do shtoja dy gjëra në mbledhjen e kaluar ne e diskutuam në mbledhjen e këshillit bashkiak dhe u dakordësuam nga 10 këshilltarë që të votohej pro. Plani nuk parashikon shtim kontrate, rishikim kontrate apo diçka tjetër në lidhje kontratën. Është një plan që i vjen në ndihmë bashkisë së Rrogozhinës është bërë një studim referuar kontratës që ne kemi nga një organizatë një ndihmesë që i vjen bashkive për planin.

Erind Tosku . Si mund ta miratojmë ne kur ju nuk po menaxhoni këto që keni. Aktualisht ju i keni për turp mbetjet në derën e shtëpisë dhe ti thua hajde bëjmë një projekt... ti nuk po bën këto njëherë unë kështu e mendoj.

Rezart Vogli . Janë të ndara.

Erind Tosku . Si janë të ndara nuk janë të ndara?!

Mitat Daja . Nuk janë të ndara fare nuk ja veln me diskutuar këtë projekt që bëni ju.



Rezart Vogli . Atëherë plani i menaxhimit të mbetjeve dhe kontrata aktuale nuk kanë lidhje fare me njëra tjetrën. Planin e menaxhimit të mbetjeve i vjen në ndihmë bashkisë Rrogozhinë dhe kujtdo institucioni tjetër për të kërkuar subvencione apo investime për bashkinë e vet në institucionet qendrore lart në Tiranë nuk ka lidhje me kontratën. Me kontratën që është aktualisht funksionale për bashkinë Rrogozhinë jam dakord me personat përgjegjës mund të bëni pyetje mund të merrni përgjigje por në këtë rast flasim për një plan menaxhimi nuk po flasim për një kontratë menaxhimi.

Erind Tosku . Ti e ke planin aktual të menaxhimit dhe nuk po e shfrytëzon.

Rezart Vogli . Nuk ka një plan aktual menaxhimi bashkia.

Silvana Aliu . Është e vërtetë që ne ramë dakord por nuk ramë dakord që ju ta çonit gjëndjen më keq e para. E dyta që janë dy gjëra të kundërta e di por menaxhoni këtë njëherë që keni që të arrini tek projekti. Ti thua hajde na sillni dhe ca lekë të tjera dhe ne ta lejmë akoma më keq.

Rezart Vogli . Kush do i sjelli këto lekë të tjera?

Silvana Aliu . Po pse po ngulni këmbë?

Rezart Vogli . Për çfarë do i kërkojmë nëse nuk e kemi planin?

Indrit Dedej . Z. Rezart unë e kuptoj që duke përfutur se ishim dakord herën e parë dhe kjo puna e plehrave na ka irrituar në çdo lloj mbledhjeje. Edhe mbledhjen që kaloi kemi sjellë foto edhe Valmirës, situata është dramatike, ti kur të rehabilitohesh si puna e Durrësit. Që të vish ti je punonjës bashkie dhe ti nuk e çan kokën fare, ti shikon vetëm veten tënde, interesin tënd edhe bashkinë e keni bërë...

Rezart Vogli . Ku është interesi im tek plani?

Indrit Dedej . Interesi jot është kjo që çfarë sjellin i çon për të dal burrë i mirë atje sipër, ato që sjellin projektet. Je punonjës i bashkisë e kupton në çfarë situatë është Bashkia e Rrogozhinës? Se ti vjen dhe relaton për gjithë bashkinë.

Silvana Aliu . Pse si ke ardhur deri tani në ndihmë qytetarëve?

Rezart Vogli . Siç miratuar planin social për Bashkinë e Rrogozhinës ashtu po flasim dhe për të miratuar...



Indrit Dedej . Bashkia ka gjetur një Rez që na vjen na relaton dhe nuk duket asnjë këtu. As nënkryetar as kryetar ju jeni bashki e falimentuar e kupton apo jo? Menimi im është se unë jam duke e parë duke e vrojtuar në terren.

-Mbledhjes i bashkohet këshilltari z. Altin Tosku në minutën e 25 të zhvillimit të mbledhjes.

Rezart Vogli . Rezi përfaqëson bashkinë Rrogozhinë nuk përfaqëson veten e vet.

Indrit Dedej . Rez ti merr përsipër vjen relaton drejtorinë e shërbimeve, ti vjen relaton edhe nënkryetarin edhe ke parasysh se ne kemi kohë të gjatë që nuk i shohim ata këtu. Është mirë që të rehabilitohemi të shikoni bashkitë komshi, po të shikosh bashkitë komshi janë shumë të pastra dhe ato e meritojnë të kalojë ai lloj projekti. Ju jeni katastrofë.

Rezart Vogli . Për planin e menaxhimit të mbetjeve janë marrë informacione nga shumë drejtori...

Indrit Dedej . Mos them që jeni katastrofë në çdo lloj drejtimi.

Enver Memolla . Kryetare faleminderit, në lidhje me projektvendimin diskutimi pothuajse u bmyllën që mbledhjen e kaluar. I bashkohem kolegëve për pjesën e mbetjeve sepse nga ajo mbledhje deri sot ka ceduar më shumë akoma puna e pastrimit të mbetjeve. Dhe propozimi im për këtë pikë është të kalojë tek dëgjesa publike e datës 5 apo 6 kur është...

Mukades Gixhari . Datë 5.

Enver Memolla . Pastaj të vijë në mbledhjen tjetër për t'u miratuar apo për t'u kaluar në këshillin bashkiak. Unë dua që kjo pikë të ballafaqohet me banorët që është atje të dy planet po me datë 5 tek dëgjesa publike të jetë e pranishme.

Hekuran Xhani . Tani në mbështetje të diskutimeve që u trajtua këtu çështja e mbetjeve. Ka një shkak Rezi që kjo gjendje se është gjithandej jo vetëm për Rrogozhinën kështu është Lekaj është Luzi Rrogozhina kush është shkak që është kjo situatë për pastrimin e plehrave? I ka mbaruar buxheti Bashkisë?

Rezart Vogli . Nuk them dot më shumë se pjesa e financës deri aty jam.

Hekuran Xhani . Tani problemi qëndron që të gjithë këshilltarët me të drejtë trajtuan problemin



e mbetjeve, tani ne fusim prap një program rehabilitimi mbetjesh. Pra në mbështetje të gjithë këshilltarëve edhe unë jam dakord edhe të z. Enver që të rehabilitohet njëherë situata ore të alarmohen të paktën atje në Luz është bllokuar rruga ja kam edhe atë çunin që kalon përditë. Është bllokuar rruga kush është shkaku ju duhet buxhet nga bashkia më tepër ta kërkojë ajo firmë kontraktore.

Indrit Dedej . Nuk kemi gjë me firmën ne, e kemi me bashkinë.

Hekuran Xhani . Tani problemi ku e di unë fondet si qëndron kjo punë pikërisht ju drejtova Rezit. Edhe unë në mbështetje ta lejmë për herë tjetër kalimin e kësaj.

Mukades Gixhari . Atëherë jemi dakord që ta kalojmë tek dëgjesa publike?

Mitat Daja . Rez tani po bëhet një projektvendim për mbetjet, pyetja ime është kjo. Kur i mbaron kontrata e këtij planit të parë që është bërë sepse ka pasur një plan tjetër?

Rezart Vogli . Nuk është bërë plan përpara për menaxhimin e mbetjeve.

Mitat Daja . Ju kur keni bërë sepse ju bëni një projekt e ktheni në tender nuk i hy unë kësaj pune është çështje tjetër. Kur i mbaron sepse ti ke rënë dakord me Mitatin psh që ka firmën që do pastrojë bashkinë e Rrogozhinës me x lekë, tani po vjen me një studim të ri shumë mirë është studimi nuk ka njeri kundërshtim me studimin, ne kemi probleme me aktualitetin dhe po thua që duam të bëjmë këtë skenarin 1 skenarin 2 se unë e kam lexuar me vëmendje.

Rezart Vogli . Në asnjë moment nuk citohet ndryshim kontrate.

Mitat Daja . Kjo vlen për t'u parë, ideja kur mbaron kontrata ...?

Rezart Vogli . Tetor 2022 - Tetor 2027 është aktive kontrata.

Mitat Daja . Atëherë në 2027 sille këtë planin dhe e diskutojmë, po ska gjë atëherë sille. Sepse e bukura është që këtu miratohen projekte studimi dhe këto

Mukades Gixhari . Atëherë në momentin që e lamë këtë pikë të rendit të ditës që do ta diskutojmë tek dëgjesa publike mendoj që duhet ta mbyllim. Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Jemi tek pika 6. Jeni dakord ta shtyjmë për dëgjese publike? Ta hedhim në votim.



Mitat Daja . Ta sjellin në 2027 nuk ja vlen ta ...

Mukades Gixhari . Z. Mitat tregojë me votë.

Mitat Daja . Nuk jam dakord fare.

Mukades Gixhari . Atëherë jeni dakord ta kalojmë në dëgjësë publike? Pro, kundër abstenim? Të gjithë pro dhe një kundra. Atëherë 2 kundra. Miratohet.

-Miratohet me 14-vota pro dhe 2 kundër (Mitat Daja, Silvana Aliu) për tu kaluar në dëgjësë publike pika 5, e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 6. Raport i auditimit të brendshëm mbi punën e bërë dhe për problematikat e evidentuara në bashkinë Rrogozhinë. Kemi përgjegjësin e auditit të brendshëm z. Nuredin Tosku.

Nuredin Tosku . Atëherë ju kam dërguar relacionin shpjegues të gjithë punës së auditit të brendshëm gjatë vitit 2024. Në këtë raport janë përfshirë të gjithë subjektet e audituara kemi përfshirë dhe Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin të cilët janë audituar gjatë vitit 2023 por që nuk kemi mundur ta raportojmë, kemi evidentuar të gjitha gjetjet dhe kemi dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e çdo subjekti të audituar. Jua kam paraqitur në relacion të gjitha këto problematika.

Mukades Gixhari . Materialet i keni të gjithë përpara pyetje për z. Nuredin.

Isa Halili . E kam lexuar auditimin është për mua me shumë vend për të gjithë problematikat që ka patur. Pyetja ime për Nuredinin është këto problematika janë të kamufluara ndër vite apo janë për vitin 2023 ku ju i referoheni? Pra janë një sërë problematikash që vijnë ndër vite?

Nuredin Tosku . Këto janë problematika për 2023.

Isa Halili . Pra këto janë për vitin 2022-2023, këto janë të shfaqura në dy vitet e fundit që nuk janë shfaqur më parë apo janë të kamufluara ndër vite?

Nuredin Tosku . Ne nuk merremi me pjesën 2017-2020 ne merremi gjithmonë, se auditit ka 4 vite që funksionon në bashkinë tonë, skemi pasur shumë auditime se kemi pasur mungesa në staf.



Isa Halili . Më konkretisht që të jem konkret me ty për Drejtorinë e Arsimit Sportit Kulturës dhe Rinisë nga auditimi juaj që keni bërë nga këto pika që keni sjellur këtu, këta janë problematika që janë shfaqur për herë të parë 2022-2023 apo janë shfaqur në auditime që ka pasur më parë ky institucion?

Nuredin Tosku . Ne nuk merremi me pjesën e mbartur ne kemi audituar periudhën 2023 dhe çfarë kemi parë nga dokumentacioni i vitit 2023 e kemi paraqitur në raport nuk merremi me vitin 2022 janë të mbartura s'janë të mbartura. Në moment që për vitin 2023 ai ka mangësi ne e paraqesim në raport. Ne parashikojmë në programin tonë periudhën që ne auditojmë dhe nuk mund të auditohen më shumë se dy vite se ka shumë volum edhe ne kemi dhe manualin tonë si funksionojmë.

Erind Tosku . Ajo që kam vënë re tek auditimi është se disa drejtori kanë shumë volum faqesh dhe paskan nuk janë bërë, nuk janë bërë asnjë i bie që ne jemi goxha që nuk janë bërë. Po prek pjesën e arsimit sepse aty ndalova pak, nga i gjithë ky auditim rekomandim në afat kohor ndaj drejtorive ka apo nuk ka? Atëherë ti mund të bësh një auditim shikon nuk kanë bërë, nuk kanë bërë, çon rekomandimet zyrave, zyrat i shohin i vendosin tek sirtari i 2017 ose 2020 aty ku kanë dhe tjera dhe vazhdojmë prap po me këtë situatë.

Nuredin Tosku . Gjatë periudhës Janar-Mars të çdo viti ne bëjmë një program vetëm për të parë nëse i kanë zbatuar subjektet apo jo rekomandimet që ne i lamë edhe pas ne bëjmë të përgjithshmen sepse mund të bëjmë 6-7 dhe bëjmë një program të përgjithshëm edhe shkojmë shohim vetëm pjesën e zbatimit të rekomandimeve. Pastaj i paraqesim në raport.

Erind Tosku . Dhe masat ndaj drejtorisë masat ndaj punonjësit ka? Sepse thashë edhe njëherë thotë ai nuk ka masa për mua i vendos ta thashë me ironi tek sirtari i atyre gjërave që nuk bëjnë në rregull si ta bëj si mos ta bëj unë jam në rregull.

Nuredin Tosku . Ne thjeshtë ngarkojmë personat me zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe ja paraqesim situatën kryetarit të bashkisë, pastaj ne propozojmë nuk marrim.

Fatmira Thartori . Ky auditim është për të gjithë bashkinë pra përfshin edhe njësitë administrative? Po shikoj auditimin e njësisë administrative Lekaj, pse konkretisht është vetëm Lekaj dhe nuk është Gosa apo Kryevidhi?

Nuredin Tosku . Sepse ne bëjmë një plan vjetor dhe strategjik një plus tre dhe i ndajmë, Gosa ka qenë para dy viteve është për këtë vit për 2025 dhe janë subjekte që ne i vlerësojmë në bazë të risqeve, subjektet me risk të lartë ne përpiqemi t'i auditojmë çdo vit, e kemi dhe tek manuali



jonë. Subjektet me risk të mesëm ose të ulët dy tre deri 5 vite, jo më vonë se sa 5 vite.

Indrit Dedej . Ju si auditues i merrni për bazë rekomandimet që ju ka lënë KLSH-ja?

Nuredin Tosku . Shumicën e rasteve ne i marrim parasysh, kur shkojmë për auditim kërkojmë raportin e KLSH-së nxjerrim pikat që ka lënë për atë drejtori dhe kërkojmë zbatimin e tyre.

Indrit Dedej . Sa nga rekomandimet e KLSH keni evidentuar ju?

Nuredin Tosku . Po e kemi shkruar në një pikë. Ne shkuam dhe kërkuam komisionin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Indrit Dedej . Sa janë të zbatueshme? Edhe përveçse rekomandimet ja lini kryetarit të bashkisë në vend tjetër keni mundësi ju me trokitur për t'i lënë këto lloj mosrealizimesh raportet? Po pra vend tjetër përveç bashkisë keni vend tjetër për t'i çuar keni të drejtë, ku?

Nuredin Tosku . Po, të gjithë punën tonë ne ja çojmë Ministrisë së Financave një drejtori mbi ne që raportojmë çdo vit .

Indrit Dedej . Sepse unë shikoj që ti këtu nga auditimi jot në disa zyra të bashkisë si për punonjësit si për ... nuk ke luajtur fare dmth nuk ke audituar fare. Psh kap tek zyra e asaj dosjeve të personelit, burimet njerëzore. Raporti i KLSH-së të ka lënë pa fund këtu ti ka lënë dhe me emra, me emra nuk i di por i ke me iniciale tani ti nga këto rekomandime ke parë realizuar...

Nuredin Tosku . Ne kemi planifikuar për ta bërë në 2025 se thashë ne gjithmonë planifikojmë...

Indrit Dedej . Si planifikon ti tre drejtori këtu pesë do i lesh për 2025?

Nuredin Tosku . Ne kemi pasur mungesë stafi, ne kemi planifikuar për vitin 2024, dhjetë auditime kemi realizuar tre.

Indrit Dedej . Po drejtorisë së financës së bashkisë për investimet që janë bërë, i ke bërë? Si ke bërë. Drejtorisë së ndërtimit nuk pashë që i kishe bërë. Më fal mu duk sikur kishe marrë ca këtu nga këto që KLSH-ja ka 230 e ca faqe, mu duk sikur kishe marrë ca dhe prap ishte treguar i sinqertë se me të vërtetë që nuk kanë bërë asgjë edhe ti je treguar i sinqertë që çfarë ke marrë këtu i ke hedhur këtu.



Nuredin Tosku . Jo ne nuk marrim asgjë nga KLSH-ja.

Indrit Dedej . Jo i ke kopjuar këtu dhe të paktën je treguar i sinqertë, është e saktë situata siç i ka lënë KLSH-ja ashtu i ke raportuar dhe ti drejtë e drejtë.

Nuredin Tosku . Mendimi jot. KLSH-ja nuk raporton kështu si raportojmë ne është i jashtëm unë jam i brendshëm.

Indrit Dedej . Kjo tregon që ty bravo të qoftë tregohu pak i sinqertë që thua realitetin siç është se bashkia ka ikur për lesh.

Erind Tosku . Fjalorin!

Mitat Daja . Tani sektori i auditit i ka përshkruar gjithë këto gjërat dhe kjo është një gjë e mirë që ka një audit që e pakta gjë ka prekur diçka të vogël por se ajo që më habit mua është që letra ka pa fund kjo s'ka bërë këtë, kjo s'ka bërë atë dhe sot këtu më e keqja është se përgjegjësi ose drejtori i auditit ka përcaktuar vitin 2023 pro tani jemi në 2024. Po të kishte ndonjë këtu që ta pyesja të kisha mundësi se normalisht drejtorat janë shumë të zënë me punë, kur lexoj që nuk ka asnjë lloj preventivi për një problematikë ose asnjë lloj hartimi doja ta pyesja po në 2024 kanë bërë ndonjë gjë një pyetje e thjeshtë ndoshta nuk përfshihet në këtë se ai ka bërë audit por është për konstatim për fat të keq bashkia po shkon drejt inekzistencës me gjithë këto që po bën. Sepse pak a shumë auditit është një sektor brenda bashkisë mos flasim pastaj për KLSH-në që është edhe më lart. Kur brenda llojit konstatohen gjithë këto probleme imagjino çfarë mund të vijë dikush ta shohi me një sy tjetër këtë punë edhe vazhdojmë të jetojmë të lumtur edhe vazhdojmë mbledhjen e radhës.

Mukades Gixhari . Atëherë ndonjë pyetje tjetër? Atëherë faleminderit z. Nuredin për informacionin. Kalojmë në pikën tjetër tek të ndryshmet. Informacion për Udhëzimin nr. 143 datë 19.07.2024 nga Komisioni Qëndror i Statusit dëshmor i atdheut. Kjo është thjeshtë për dijeni të nderuar këshilltarë.

Për të kaluar tek pika 2 e të ndryshmeve për zotërinjtë e nderuar që na kanë respektuar me pjesëmarrjen e tyre përfaqësues të policisë, të bashkisë, administratës së arsimit në bashki. Siç u thashë më lart kemi njoftuar përfaqësues të policisë, të arsimit, të bashkisë nisur nga ngjarja e rëndë e ndodhur para dy ditësh datë 18.11.2024 pranë shkollës “Fan Noli” në Tiranë, ku një 14-vjeçar humbi jetën pasi u godit me thikë nga bashkëmoshatarit i tij. Duke qenë se në rang kombëtar për fat të keq janë vërejtur raste të shtuara të konflikteve fizike apo të mbajtjes dhe përdorimit të armëve të ftohta nga ana e adoleshentëve, me kërkesë të këshilltarëve ju kemi



thirrur të nderuar zotërinj të shqyrtojmë masat që do ndërmerren në vijim që të parandalojmë rastet e dhunës në të gjithë format e saj mes adoleshentëve në ambientet e shkollës por dhe jashtë saj në Bashkinë Rrogozhinë. Nga këshilltarët ka ndonjë që e don fjalën? Është shefi i policisë bashkiake z. Lorenc Boriçi. Përshëndetje!

Lorenc Boriçi . Ne do të marrim të gjitha masat dmth për parandalimin e këtyre që ndodhin nëpër shkolla, problematikat me nxënësit për sherret për armëmbajtje të ftohta.

Mukades Gixhari . Atëherë nga këshilltarët z. Indrit.

Indrit Dedej . Përshëndetje! Të uroj për detyrën e re, a mund të na thuash çfarë lloj profesioni keni pasur më parë dhe çfarë shkolle keni mbaruar?

Lorenc Boriçi . Po kam mbaruar fakultetin ekonomik.

Indrit Dedej . Dhe sa kohë keni që keni filluar në pozicionin që je?

Lorenc Boriçi . Rreth 2 javë.

Indrit Dedej . Këto dy javë çfarë ke parë ti që nuk shkon në punën e përditshme të policisë bashkiake Rrogozhinë çfarë ke evidentuar ti për këto dy javë policia e ke në rregull, ku di unë? Sepse policia bashkiake mbulon komplet territorin e bashkisë brenda që policia e shtetit është e distancuar. Policia e shtetit është vetëm kur kërkohet ndihmë nga ju.

Lorenc Boriçi . Policia bashkiake është prezente në çdo shkollë në çdo kopësht.

Indrit Dedej . Në shkollë unë e kam evidentuar që është në rregull, kurse me qarkullimin unë e shoh që nuk jeni në rregull fare. Sepse unë shikoj që para kopështit para shkollës ndalojnë tre makina rreshtë nuk është detyrë e policisë së shtetit që të vijë të heqi makinat është detyrë e juaja. Ti sa je në gjendje këto dy javë çfarë ke parë, ke dalur në terren apo s'ke dalur?

Lorenc Boriçi . Makina ndalon një minutë sa zbret fëmija.

Indrit Dedej . Këto dy javë sa gjoba keni vënë?

Lorenc Boriçi . Aq ndalon, tani je i detyruar ta lesh të zbresë fëmijën.



Indrit Dedej . Po pse para institucionit nuk je i detyruar nuk je fare mund të ndalosh 100 metra më poshtë.

Lorenc Boriçi . Ka të drejtën e vet ai.

Indrit Dedej . Çfarë të drejtë ka?

Lorenc Boriçi. Të ndalojë pra.

Indrit Dedej . Unë kam ndenjur 10 minuta aty kisha parkuar, ndaloi aty më hapej edhe kështu si i fortë. Polici bashkiak ishte aty dhe i thashë po ti, çfarë të bëj unë tha rrogën s'ma ngrejtët tha.

Lorenc Boriçi . Është ngrejtur s'është ngrejtur rroga ai ka për detyrë të zbatoj.

Indrit Dedej . Po këtë po them këto dy javë se unë nuk të ve shumë faj ty, se dy javë do të njihesh.

Mukades Gixhari . Të përqëndrohemi tek rasti, se për atë e kemi thirrur zotërinë.

Indrit Dedej . Zysha ky është rasti se makina shtyp fëmijën e vogël. Në momentin që ai nuk zbaton rregullat shtyp fëmijën se ai nuk ka të drejtë të futet brenda ambientit të shkollës dhe ai nuk ka të drejtë të kontrollojë qytetarët për armë të ftohta, se është policia e shtetit. Apo ke të drejtë të kontrollosh për armë të ftohta? Edhe për hashash s'ke të drejtë.

Lorenc Boriçi . Të drejtë kontrollimi jo edhe për hashash por në qoftë se e shikon polici ka të drejtë. Të ndërhyjë si qenka kjo ta lejojë të bëjë çfarë të dojë të vrasë njerëz.

Silvana Aliu . Për rastin në fjalë ngushëllime familjes është një ngjarje shumë e rëndë për të gjithë. Të dyja policitë kanë qenë të pranishme nëpër shkolla por personalisht mendoj që raste të tilla jashtë shkolle ok jam dakord por brenda shkollës është mësuesi, psikologu është punonjësi social, sepse figura e një polici që të vijë është terror për nxënësin. Ndërsa për rastin më shumë punën duhet ta bëjmë ne.

Enver Memolla . Faleminderit kryetare. Në lidhje me rastin është një rast shumë i rëndë por duke ditur dhe pjesën e teknologjisë, kur kemi qenë në shkollën tonë kontrolloheshim të gjithë për telefona, për armë të ftohta për biçakë, madje dhe prerësja e thonjve na hiqej nga duart. Kjo është brenda shkollës, tani unë pyetjen për drejtorin e bashkisë e kam për jashtë territorit. A ka



evidentuar policia bashkiake tregjet që shesin armë të ftohta, janë të lejueshëm në bazë të ligjit nuk janë, a ja shesin të miturve apo jo. Sepse do dalim tek policia e rendit se si i mituri rekrutohet për të marrë thikën, në “tik tok” të gjithë i shohim nga mësuesit nga ne të gjithë nxënësit. Dhe nga “tik tok-u” duhet bërë reagimi brenda në klasë pastaj nga mësuesi kujdestar nga psikologu dhe nga oficeri i sigurisë për t’i kapur hallkat zinxhir një nga një. Nuk është për të bërë politikë në këtë rast është për të vënë duart në kokë, unë dal në 7 të mëgjesit dhe e dijmë shumë mirë kush ka “tik tok” kush promovon dhunë cigare apo dhe ato elektronike. Ndaj po i drejtohem drejtorit të policisë bashkiake. Në tregjet e Rrogozhinës a shiten mjete të ftohta?

Lorenc Boriçi . Raste konstatimi nuk kemi pasur që të shikojmë për aq kohë sa jam unë.

Enver Memolla . Ke një akt kontroll që të ma paraqesësh? Se me fjalë ka shumë, ke tregjet të Hënë, të Mërkurë, të Shtunë kur janë në Rrogozhinë për të bërë evidentimin që të mos lejohet t’i shitet të miturve se ai mund të marrë dhe thikën e bukës në shtëpi nuk mund ta ruash ti. Por këtu lind dhe këtë shkas e marr dje nga një emision investigativ që e pashë mbrëmë në Tiranë, janë ca gjëra dhe këtu duhet të ndërhyjë dhe pjesa ligjore. Këtu tek pjesa jashtë janë masat tek policia bashkiake dhe e rendit kurse brenda duhet të ngrihet niveli i mësuesit, sidomos mësuesi kujdestar. Nuk e di shkollat 9- vjeçare më duket nuk kanë polic sigurie.

Alime Hoxha . Jo nuk kanë.

Enver Memolla . Nuk kanë. Dhe detyrohen mësuesi të jetë oficerë sigurie.

Indrit Dedej . Mësuesi dhe psikologu të dy duhet të rakordojnë me drejtoreshën.

Enver Memolla . Duke parë shihet sjellja e nxënësit në klasë, të gjithë e kemi kaluar atë mbresë ne kur ishim në shkollën tonë kur na drejtonte rasti u thirrte policia e rendit. Ka pasur raste të tilla? Se në qoftë se bëjmë një rast dy tre dhe nuk reagohet bëhet e rrugës se shih rrushi rrushin dhe piqu ose kalbu pastaj dhe këto janë masa që duhet të merren brenda shkollës, sidomos nga kjo të gjithë nxënësit mund t’i kenë në instagram mund t’i shohin të gjitha. Dhe nga një video që mund të çojnë apo screenshot dhe aty duhet të reagojë duke thirrur prindin, duke thirrur nxënësin, thirrur mësuesin kujdestar që të fillojë riedukimi.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Enver. Z. Isa Halili.

Isa Halili . E para njëherë jo për atë që ndodhi por në tërësi flasim për problematikat që kemi këtu në qytetin e Rrogozhinës, janë pa fund ata të rinj të cilët prishin rendin dhe qetësinë e



qytetit. Nga një konstatim i bërë së fundmi ku isha pjesë vetë dhe pre e kësaj gjëse fatkeqësisht, konstatova nga njerëz të cilët punojnë dhe që me nder krenari privilegj na kanë udhëhequr na kanë mbrojtur si policia e shtetit. Më erdhi jashtëzakonisht shumë keq kur më thanë që policia në këtë situatë është në situatën më alarmante të mundshme nuk e them këtë këtu tani për t'i dhënë mend personit në fjalë por që ne të gjithë së bashku duhet që të reagojmë sepse kjo është një problematikë shumë shumë e madhe. Janë pa fund ata fëmijë të cilët intimidohen, kanë frikë bullizohen nga shoku sepse shoku është më i fortë, se ka shokë të tjerë të fortë dhe këta njerëz që janë të fortë kemi qenë vetë nxënës e kanë dëshirën dhe unë bashkohem me Verin që edhe ta reklamojnë këtë gjënë pra këta janë njerëz krejtësisht të evitueshëm. Aq më tepër në një komunitet si Rrogozhina ku gjithsecili e njeh mjaft mirë njëri tjetrin. Kemi fatin e mirë këtu që në këshillin bashkiak ka shumë mësues, unë besoj që nuk dua ti bëj me faj për profesionin dhe për të gjithë atë që kanë kontrubuar ndër vite. Por besoj që nuk duhej të prisnim këtë moment që ky të ishte një alarm për të gjithë ne. Sepse e thashë isha në komisariatit e Kavajës dhe tek sa për një person ka ardhur 14 herë këtu në komisariat vetëm për 2024. Person që sillte problematika jo vetëm për shokët dhe komunitetin dhe për moshën që ai kishte por edhe për njerëz më të mëdhenj. Të pasurit frikë dhe të jetuarit frikë në 2024 është e papranueshme për gjithë secilin prej nesh. Sepse fjalja e fundit e mbylla duhet të jemi të gjithë shumë të vëmendshëm ndaj kësaj historie se gjithësecili nga ne ka disa kredite mbi supe ka familjen e vet ka dinjitetin e vet dhe nuk është aspak por aspak e natyrshme që të bëhet pis nga njerëz që duhet të jenë pas hekurave pavarësisht moshës që ata kanë. Faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Z. Mitat.

Mitat Daja . Atëherë për rastin. Rasti me të vërtetë është shumë i rëndë dhe ngushëllime dhe familjes së fëmijës së vogël. Ajo që unë konstatoj duke qenë dhe mësues dhe duke qenë dhe këtë vit kam pasur mundësinë të vizitoj dhe disa shkolla është një mungesë e theksuar e kordinimit të drejtuesve të institucioneve arsimore. Ne kujtojmë se duke e fshehur diçka ose duke e mbajtur brenda vetes duke mos e shfaqur ose duke mos e denoncuar do fitojmë e kundërta ndodhi dhe rasti i Tiranës na tregoi që këtu duke e mbajtur ata në vete dhe duke mos e çuar në institucionet përkatëse ndodhi më e keqja. Prandaj unë do kërkoja sot meqë kemi prezent policinë bashkiake, policinë e rendit dhe drejtoresha e zyrës arsimore është këtu do kërkoja që të ketë një kordinim të plotë të rasteve sepse duke qenë mësues thashë që në fillim kam pasur dhe raste që ishte për të vënë duart në kokë. Dhe nuk dua të përmend raste konkrete sepse dalin dhe gjëra konkrete por se është shumë shumë e rëndësishme kordinimi dhe duhet një plan masash për të gjithë ato institucione për të kordinuar punën për t'i parandaluar problemet. Sepse fundja ato fëmija janë, janë të ndikueshëm kanë mendjen e tyre por se duhen masa paraprake për të parandaluar. Dhe shpresoj që të ketë një plan masash të tillë dhe të na tregohet.



Mukades Gixhari . Faleminderit. Z. Sokol Gosa.

Sokol Gosa . Faleminderit kryetare. Politikat e mëdhaja për heqjen e këtyre rrjeteve sociale “TikTok” do t’i bëjë qeveria dhe ishallah shumë shpejt të mos kemi as rrjete asgjë. Por të parandalojmë apo të zgjidhim diçka këtu ku jemi meqë janë dhe institucionet përkatëse tek drejtori i ri dmth nuk ka atë përvojën eksperiencën ndoshta dhe nuk mund t’i kërkojë diçka por vetëm ta këshilloj që me policët e vet të jetë më i pranishëm tek shkolla. Ju e thatë që jeni aty por ama janë thjeshtë vetëm vëzhgojnë nuk ndërhyjnë, unë kam pasur raste psh tek gjimnazi nuk kanë ndërhyrë që ata shumë mirë mund të ndërhyjnë se janë edhe djem të rinj dhe t’i eliminonin këto konflikte qëndrojnë indiferentë më shumë këtu e kam. Tjetra aty parkohen me makina me motorra vijnë dhe çuna të rinj, them ty por i them dhe punonjësve të policisë së rendit që të paktën këto problematikat janë shumë shqetësuese, janë të përditshëm na vijnë me motorra brenda në shkollë, asnjë ndalesë asgjë me makina me shpejtësi, asnjë si ndalon që këtu fillon ajo punë. Me këto që janë jashtë oborrit të shkollës kurse me probleatikat e brendshme është një punë shumë shumë e madhe që unë biles janë shumë të vonuar që nga Ministria e Arsimit zyra arsimore e jona që nuk dolëm me një plan masash broshurë ta quajmë si të duam, çfarë do bëjmë si do reagojmë? Nuk patëm një mbledhje një takim, ajo ndodhi hajt të parandalojmë, hajde urgjente të ishte bërë që të nesërmen, unë këto kisha.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Sokol. Tani të ja japim fjalën drejtoreshës së zyrës arsimore për bashkinë Rrogozhinë znj. Alime Hoxha.

Alime Hoxha . Faleminderit kryetare. Tani të gjithë e dimë jemi të gjithë të prekur nga kjo ngjarje, është një ngjarje shumë e rëndë aq më tepër ne që jemi pjesë e arsimit dhe na prek drejtpërdrejtë. Tani u ngritën shumë probleme policia, policia bashkiake dakord kanë secili pjesën e vet edhe zyra ka pjesën e vet. Puna kryesore është brenda shkollës ne nuk e shmangim dot rrjetet sociale janë bërë pjesë e jetës, janë bërë pjesë e jona e jo më pjesë e fëmijëve. Fëmijët janë çdo ditë me telefon në dorë, çdo ditë shikojnë atë që atyre i pëlqen. Aty ne e dimë të gjithë që promovohet nuk ka një kontroll që promovohet dhuna si pjesa kryesore ajo duket me ato video që ato bëjnë në “TikTok” dhe ajo është jeta. Këtu në fakt ka një problematikë shumë të madhe në të gjithë aktorët e shoqërisë si nga familja nga shkolla dhe nga gjithë shoqëria. Rolin thelbësor e ka dhe familja, tani ne kemi një ligj ku të gjithëve ju është bërë e ditur që telefoni nuk lejohet në shkollë. Prindërit e nisin me telefon në mëgjes në shkollë më justifikimet nga më të ndryshmet, mësuesit e kanë të ndaluar t’i pranojnë nxënësit me telefona prap dhe kjo është e pashmangshme sepse ti nuk mund të kontrollsh çdo ditë fëmijën. Kanë gjetur mënyra nga më të ndryshmet disa mësues ja mbledhin në mëgjes telefonat, ka dhe nxënës jemi koshientë që kanë dhe të nevojshëm vijnë nga zona të ndryshme i duhet dhe telefoni për të komunikuar me



prindërit. Kanë gjetur dhe metoda për t'i marrë telefonat për t'i dhënë në fund të mësimit por dhe kjo ka çaluar thashë sepse është diçka që është e pashmangshme, telefoni është një mjet komunikimi. Dhe ajo që dua të ngul këmbë është pikërisht puna që duhet të bëjnë mësuesit me psikologët dhe me drejtuesit e shkollave. Ne na çalon pikërisht tek mësuesit sepse mësuesit janë ata kryesorët që identifikojnë nxënësin që shikojnë ndryshimin e sjelljes dhe në momentin që shikon ndryshimin e sjelljes duhet ta referosh rastin tek psikologu, psikologu bën këshillimet e veta kur e shikon që nuk arrin të zgjidhi do ta referojë rastin tek Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës në Bashki pastaj në polici. Tani ne të vërtetë themi roli i policisë nuk na ka munguar në dijeninë time kur i është kërkuar ndihma policët aty kanë qenë qoftë tek gjimnazi qoftë tek shkollat 9-vjeçare. E theksoj tek kjo pjesë se shkollat e fshatrave duke qenë pak më të vogla me më pak nxënës nuk kanë kaq shumë problematika por i kemi problematikat në Rrogozhinë dhe në Gosë që kemi dy shkollat më të mëdha. Tani mësuesit heshtin nuk e çojnë problemin ose gjejnë atë zgjidhjen më të lehtë që e nxjerrin nxënësin jashtë nga ora e mësimit që në mënyrë kategorike nuk duhet ta nxjerrin se që aty bëjnë shkelje vetë ligjore dhe pastaj e kërkojmë llogarinë tek tjerët. Bashkëpunimi me prindërit për çdo lloj problematike prindi duhet të jetë në dijeni dhe është detyrë po e mësuesit kujdestar ta vejë në dijeni prindin. Tjetër ne themi që kush është për burg ta çojmë në burg nuk është kjo nuk do t'i çojmë njerëzit në burg se bëri një gabim apo doli tek rrjeti social është ideja si ta fusim në rrugë dhe shkollat pikërisht për këtë janë për t'i edukuar. Këto janë problematika që ne i hasim çdo ditë dhe duhet që mësuesit them mësuesit ngul këmbë se një pjesë e mirë këtu janë mësues dhe e dinë shumë mirë që kjo problematikë është kryesore. Sa për reagimin nga ZVA-ja unë mbledhjen me drejtuesit e kam bërë me psikologët e kam bërë me oficerët e sigurisë këto janë aktorët kryesorë që e luajë atë rolin dhe ja kam lënë secilit detyrat që ka, këto kisha.

Mukades Gixhari . Faleminderit znj. Alime. Z. Isa.

Isa Halili . Atëherë unë jam plotësisht dakord me gjithçka arsyetoi parafolësja por ajo që dua të them është dakord ne ndoshta e kemi të pamundur që të ndalim rrjetet sociale por meqenëse qenka problematika tek mësuesit pse duhet...

Mukades Gixhari . Sa më shkurt se e more njëherë fjalën.

Isa Halili . Po patjetër, pse duhet pikërisht të ndodhte kjo gjëja për të diskutuar kjo se unë kam përshtypjen që situata nuk është aq e qetë në Rrogozhinë qoftë një njeri, dy, pesë dhjetë nxënës që mundet të prishin rendin dhe qetësinë e asaj gjëje. Pra a janë evidentuar njerëz të cilët kanë një sjellje jo të logjikshme në ambientet e shkollës dhe pastaj çfarë është bërë nga këta instanca që juve konstatoni që keni patur mbledhje me policinë a ku ta di unë me prindërit. Çfarë bëhet



gjatë kësaj periudhe sepse dakord një njeri për sjelljen e tij i ndikuar nga familja ndoshta nga mësuesi që nuk po bën ndoshta detyrën e tij që mund ta nxjerri një moment jashtë por problemi është kush është zgjidhja. Sepse ka dhe aty njerëz pa fund që kanë ardhur për të mësuar dhe për t'u edukuar dhe pse duhet të priset i gjithë po themi gjëja e mirë po themi që bën arsimit nga pak individë. Pse qenkemi ne kaq të pafuqishëm që mos marrim masa për këta njerëz të cilët janë me një sjellje të cilët e agravojnë situatën në komunitetin ku ndodhen?

Alime Hoxha . Nuk thashë në asnjë moment që e kemi problemin ne mësuesit apo e kemi nuk duam të bëjmë mësimin por që nuk është marrë asnjë masë. Ka masa që merren.

Isa Halili . Cilat janë masat që merren?

Alime Hoxha . Këshillim me psikologun e shkollës, referimi i rastit kur ka qenë e nevojshme dhe në polici dhe në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijës e kemi këtu, pastaj masat e tjera i ka shkolla brenda institucionit që marrin masa të paralajmërimit të përjashtimit ka të gjitha hallkat për shkollën e mesme. Për shkollën 9-vjeçare ti nuk ke masa për të marrë sepse nxënësi është i detyruar ta ndjekë dhe ti vjen deri tek ulja e notës në sjellje, këto janë masa që i merr drejtorja e shkollës në bashkëpunim me komisionet që ka atje.

Isa Halili . Ajo çfarë unë dua të them është kjo çfarë është bërë a ka pasur një zgjidhje si është situata, a ka ndryshuar situata?

Erind Tosku . Isa nuk jemi këtu me kërkuar llogari .

Alime Hoxha . Patjetër që janë marrë masa dhe janë zgjidhur plot problematika që kanë qenë nëpër shkolla nuk kanë mbetur pa u zgjidhur.

Erind Tosku . Shyqyr Zotit shkolla tona kështu rastesh të mëdha nuk kemi pasur.

Indrit Dedej . Një pyetje kam për drejtoreshën e ZA-së. Po për mësuesit a ka ndonjë ditë që kanë të drejtë dhe ato të kontrollohen tek psikologu? Apo tek mjekësia pa i ofenduar të gjithë, se dhe ato ndonjëherë nuk janë në rregull me veten.

Alime Hoxha . Psikologu ka të drejtë e ka për detyrë të japë dhe vlerësim dhe për mësuesin.

Indrit Dedej . Këtë doja të thoja se ka mësues që nuk janë në rregull për vete.



Silvana Aliu . Pikërisht bëtë mbledhje dhe gjetët shtresën që përditë e cënoni e mësuesin e shkretë e telendisni e keni çuar dhe në Kavajë në polici kur nuk e pati nxënësin në klasë fare. Bravo ju qoftë! Po mirë unë si mësues e nxorra njëherë përjashta e nxorra dy herë ajo drejtoresha jote nuk paska qenë fare e vëmendshme të shohi se ky fëmijë që po del përjashta qenka problematik.

Alime Hoxha . Është problematikë për të gjithë kjo unë nuk thashë që është problem vetëm i mësuesit janë hallkat që duhet të funksionojnë brenda institucionit.

Silvana Aliu . Brenda klasës unë jam në gjendje ta menaxhoj fëmijën super, fëmija më rrinë e të gjitha. Atëherë kur fëmija del përjashta e kujt është përgjegjësia që ndodh pse bie tek mësuesi?

Alime Hoxha . Je brenda territorit të shkollës për aq kohë sa je brenda territorit të shkollës do ta drejtosh ti atë nxënës.

Silvana Aliu . Ok dhe unë të garantoj që brenda territorit të shkollës mësuesit janë perfekt por ndiq pak ato tjerët se nuk i ke në rregull ato që i ke mbledhur nuk i ke pasur në rregull.

Indrit Dedej . Fol për vete.

Silvana Aliu . Për shkollën time po flas. Po pra ti je në rregull ka mësues që duhen çuar tek psikologu.

Silvana Aliu . Po të vijnë të tjerët përditë në shkollë si puna ime nga ora tetë deri në një do funksionojë.

Erind Tosku . Në radhë të parë faleminderit që institucionet që policia bashkiake, policia e shtetit janë prezentë me vështirësitë e tyre që kanë unë i falenderoj. Por kjo situatë do më shumë vëmendje tek pjesa e institucioneve arsimore sepse janë pjesa më vulnerabël janë eksloziv nga momenti në moment llogjika e tyre është momnetale dhe nuk mendojnë për pasojat çfarë ndodh më pas. Gjithashtu mos bëjmë si zakon tre ditë zgja çudia dhe vazhdojmë po prap rutina e zakonshme për disa problematika që kanë makinat me shpejtësi, makinat që janë dyshe dhe pengojnë hyrjet e daljet në shkollë ose daljet emergjente apo indiferentizmi këto gjëra të mos përsëriten ose mos të jenë më aq të dukshme sa i shohin të tjerët. Por gjëja që unë kam më merak është të paktën të ndryshojmë kjo është një këmbanë alarmi për të gjithë ne për mësuesit për prindërit për policinë e shtetit për policinë bashkiake për çdo person që ndikon direkt apo indirekt në institucionet arsimore. Ju lutem shumë si arsimtarët si të tjerët të bëjmë një punë më



të fortë që mos i çojmë me libra e t'i kthejmë me lule pastaj.

Sokol Gosa . Ne të gjithë jemi të prekur nga kjo situatë nga kjo ngjarje apo dhe shumë e shumë të tjera por ne nuk na vjen mirë ose nuk pranojmë vetëm një fakt. Politizimin e tejskajshëm si të arsimit si të policisë, si të administratës nga kjo vjen çdo gjë. Pse them politizim? Derisa ke drejtues që i ka caktuar partia që këtu ke marrë fund edhe në arsim prandaj ka shkuar ky arsim edhe ndodhin këto ngjarje ka degraduar në këtë farë feje vetëm për këtë arsye. Që nga pastruesja po them apo roja e shkollës e të gjithë po nuk patën bindje partiake po nuk patën tundur flamurin në fushatë nuk të fusin. Po të zbatohet jemi kolegë Des edhe me këto zonjat e zotërinjtë e nderuar , të zbatohet thjeshtë rregullorja e shkollës. Kush është rregullorja?-Orari, 8 pa 20 në oborr të shkollës. E dyta ne na vijnë çuant gocat pa çantë ose vijnë me çanta fallco pa libra, na vijnë në orën 9, 10, ne prap i tolerojmë ose bëjmë disa punojnë lodhen mundohen. Është më skandaloze të them jemi kthyer roje nuk bëjmë dot punën tonë, flasi Erindi jemi tek gjimnazi apo Alimeja që ishte deri dje tek gjimnazi. Pastaj mblidhen zinxhirë këto të tjerat edhe policia që nuk ka faj se ashtu i thotë eprori mos këtu e mos atje, leje këtë makinë të kalojë se është i joni na ka dhënë votën do na japë votat. Jo pra, jemi shoqëri që nuk e di po jetojmë ato ishalla momentet e fundit të një tranzicioni të thellë e pastaj një përmbysje revolucion të paktën të futemi në rrugën e Zotit. Falemiderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Sokol. z. Mitat.

Mitat Daja . Atëherë ajo që kisha unë, insistoj që në fillim problemi është edhe unë ngre një pyetje, drejtorat e shkollës sa raste kanë referuar problematikat sepse po bëjmë sikur nuk kemi asnjë lloj problemi, sa raste kanë referuar zyrës arsimore, mbrojtjes së fëmijëve, policisë bashkiake apo policisë së rendit sepse e vërteta është që ne jemi aty dhe i përjetojmë çdo ditë. Na vijnë fëmijët të mpirë i është mpirë truri sepse një ditë përpara mund të ketë konsumuar lëndë që i kanë mpirë trurin dhe ne e gjejmë veten të pambrojtur. Kushdo qoftë se tani nuk do flasim për emra konkretë sepse nuk është mirë se normalisht ato duhet të ishin që të gjithë këtu sot dhe të thoshin ne kemi referuar por unë jam me Kolin në këtë aspekt ku problemi më i madh fillon nga koka nga drejtorët e shkollave ata nuk e imagjinojnë se po na dëgjon dhe publiku ka që në Shtator se Reni është tek mjekësia, ka që në Shtator që nuk marrin pastrues për banjot e shkollës kanë marrë dy copa açe dhe vazhdojnë dhe nuk flasin asnjëherë sepse kanë frikë se po të flasin do i bëhet gjëma. Se o do vdesin drejtorat o nuk ka.

Mukades Gixhari . Të flasim për rastin në fjalë...

Mitat Daja . Për këtë po flas pra drejtorat e shkollës sa raste kanë referuar në zyrë arsimore se



nëse nuk kanë referuar raste, atëherë në zyrë arsimore apo në polici ne flasim kot se ja kemi kaluar Zvicrës. Apo nuk është kështu ne i kërkojmë llogari vetëm mësuesit, mësuesi nuk e bën punën e vet po dakord nuk e bënka mësuesi punën e vet le ta gjejmë tek instanca tjera ne po flasim për këtë rast.

Alime Hoxha . Bashkëpunimi është mësues psikolog drejtor.

Mitat Daja . Po sigurisht.

Mukades Gixhari . Të lutem ke folur tre herë për tqë njëjtën çështje thamë do flasim vetëm një herë.

Mitat Daja . Të lutem zysh mos ma ndërpre fjalën nuk po e them vetëm për ju këtu them ta dëgjojë publiku. A ka raste të referuara, të problematikave nëpër shkolla, në zyrë arsimore në institucionin e bashkisë ku janë mbrojtja e fëmijëve? Sepse fëmijëve i është thënë vetëm që keni të drejta nuk i është thënë kurrë që keni përgjegjësi nga gjithë ato institucione keni të drejta përgjegjësi kurrë. Këtë po pyes dhe e lidha me këtë punën e atyre që kanë që në Shtator që kanë marrë dy kutija Açe dhe kaq mjafton sepse problemi më i madh jemi dhe ne që heshtim se dhe ne jemi aty kalojmë dhe nuk durohet era e banjove kur kalojmë është dhe ne jemi problem. Se kolegu im thotë nuk ka pasur magazinier që të firmosë qenka keq e më keq situata ne mblidhemi kot.

Mukades Gixhari . Të lutem z.Mitat ta dëgjojmë pak dhe kolegun, kanë të drejtë të gjithë ta thonë nga një fjalë. Z. Hekuran.

Mitat Daja . Dakord por do flasim dhe ne.

Hekuran Xhani . Unë bashkohem me kolegët duke i shprehur keqardhjen familjes për humbjen e nxënësit 14-vjeçar por ne këtu trajtuam kryesisht shkaqet që çojnë fëmijët në këto probleme. Unë doja të theksoja që telefoni rrjetet sociale po kryesore është familja dhe shkolla. Unë dëgjova këtu me shumë respekt këshilltarët që janë mësues edhe thonë më vjen pa çantë nxënësi më vjen i mpirë nga trutë, tani është detyrë e atij mësuesi ose pedagogu të lidhet urgjentisht me familjen. Të njoftohet familja nuk është për të bërë luftë mësuesi është për të edukuar nxënësin...

Mitat Daja . Po e devijon problemin...

Hekuran Xhani . Tani një minutë...



Mitat Daja . Nuk gjykojmë dot familjen ne këtu sot.

Hekuran Xhani . Tani familja duhet të jetë e informuar për çdo shqetësim që ka nxënësi e para. E dyta çdo shkollë ka rregulloren e brendshme dhe nuk e mban këshilli bashkiak mirëfunksionimin e shkollës, as drejtoresha e mban rregullorja, e mban ligji.

Mitat Daja . Të sqaroj pak se jam mësues dhe e di shumë mirë se çfarë është rregullorja e brendshme...

Mukades Gixhari . Z. Mitat nuk ta ndërpreme fjalën të dëgjuam të gjithë.

Hekuran Xhani . Ne sot jemi këtu për të rritur dhe larg qoftë rrezikun që të mos na ndodhi në bashkinë tonë këshillin tonë edhe për ta rritur këtë objektiv duhet dhe e vetmja armë për ta zgjidhur është bashkëpunimi familje shkollë. Në rast se vazhdon ky rakordim unë them që nuk do të ketë probleme, tani edhe me këto rrjetet sociale ne jemi këshilltarë unë shoh edhe ne këshilltarët me një barrë thinja shoh ato që shkruhen aty problemi është gjërat duhen marrë seriozisht as për politikë. Zgjidhja është kjo Mitat ti je pedagog bashkërendimi mësues familje pasta policia, policia bashkiake do jenë aty në moment që do kërkosh ndihmën ti si mësues apo ai si prind.

Mukades Gixhari . Z. Enver Memolla .

Mitat Daja . Të mbaroj unë njëherë.

Mukades Gixhari . Të lutem z. Mitat nuk ka asgjë personale me ju që e ke marrë fjalën 4 herë. Kanë të drejtë të gjithë këshilltarët të flasin, jemi të gjithë pjesë e arsimit dhe e dimë se ku na dhemb për atë që ka ndodhur dhe për atë jemi mbledhur.

Mitat Daja . Po këtë po them por po devijohet problemi.

Mukades Gixhari . E kemi dëgjuar disa herë.

Hekuran Xhani . Çfarë devijimi ka këtu o Mitat nuk kemi ardhur këtu me bërë shkencë katër një diskutim një temë...

Mitat Daja . Ta lejmë fare.



Hekuran Xhani . Po katër herë o burrë, hajt mbajmë referat nga një orë.

Enver Memolla . Tani për t'u mbajtur dhe rendi i ditës dhe respektit të thirrjes tonë për policinë e rendit. Ato zotërinjtë kanë lënë punën dhe janë këtu në thirrje për respekt tonin. Tani t'i japim fjalën atyre dhe çfarë ka për të diskutuar këshilli nuk e ka mbyllur akoma mbledhjen vazhdojmë më pas, vazhdojnë zotërinjtë kryejnë punën e vete dhe ne vazhdojmë punën mbrapa.

Silvana Aliu . Mitat meqë je mësues në shkollë meqë ne nuk jemi në dijëni të rasteve di ndonjë rast ti kur i kemi denoncuar ne nuk kemi qenë të aftë? Se konkretisht ti nuk ke shumë marrëdhënie me nxënësin, di ndonjë rast ti dhe ne na ka kaluar?

Mitat Daja . Edhe një herë tjetër nuk e kuptova.

Silvana Aliu . Edhe ti mësues je.

Mitat Daja . Tani ti mos merr dëshmi, unë nuk jam për të dhënë dëshmi. Po di raste para ca kohësh nuk kam qenë në këshill bashkiak atëherë.

Silvana Aliu . Po ti nuk vjen në shkollë.

Mukades Gixhari . Atëherë znj. Fatmira çfarë kishit për të shtuar?

Fatmira Thartori . Të dëgjojmë dhe policinë e rendit për situatën dhe çfarë masash kanë marrë ato, dhe do të marrin në vazhdimësi.

Mukades Gixhari . Ndonjë përfaqësues të na vijë të na relatojë.

Haki Met-hasa . E nderuar kryetare, të nderuar këshilltarë! Unë që po ju flas jam përfaqësues i stacionit të policisë Rrogozhinë Haki Met-hasa e kam emrin në lidhje me temën që keni menduar ta trajtoni në këshill bashkiak është një temë është një rast që për të gjithë ne është i dhimbshëm se jemi familjarë të gjithë jemi prindër kemi fëmijë në shkollë kemi nipër kemi mbesa dhe askush nuk do që siguria të jetë që të shkojë deri në ngjarje kriminale. Kjo temë që diskutohet dhe që ju keni marrë në shqyrtim është taman në kohë, ne të gjithë siç jemi këtu duhet të punojmë në familje me fëmijët tanë, duhet të punojmë në rrethin tonë shoqëror, duhet të punojmë në ato institucione ku jemi që të bëjmë punën si duhet sipas rregullores, sipas ligjit sepse edhe kjo është një formë për të parandaluar çdo ngjarje kriminale. Lidhur me masat që ka marrë policia e shtetit edhe ne konkretisht këtu për mbarëvajtjen e sigurisë në shkollë në çdo vit me



fillimin e vitit të ri shkollor hartojmë plan masash dhe ura shërbimi me persona konkretë dhe marrim pjesë në takime me drejtuesit e shkollave në mëngjes kur hyn nxënësi në shkollë me oficerin e sigurisë me punonjësit socialë, me psikologun ku ata hartojnë raporte javore. Në lidhje me bashkëpunimin ne jemi çdo ditë në ndjekje të problematikave që kemi në shkolla. Deri tani është rast i mirë që ne në territorin që mbulojmë këtu bashkia e Rrogozhinës nuk kemi pasur raste të tilla edhe themi që nuk do kemi në qoftë se ne të gjithë do të vihemi në lëvizje që këtë problematikë mos kemi. Tani çfarë konstatoj, të gjithë këshilltarët për vërejtjet për konstatimet që bëhen në adresën e policisë së shtetit i mirëpres këto nuk janë kritika që mua më revoltojnë, më vejnë në siklet por ne do ta bëjmë program pune që këto gjëra t'i përmirësojmë, që t'i vijmë sa më shumë në ndihmë komunitetit ku jemi këtu ku shërbejmë, ku paguhemi me qëllim që të mos kemi ngjarje të tilla. Thanë shumë mirë 2-3 këshilltarë ka problematika, dikush prish rendin qetësinë duke lëvizur me biçikletë, dikush parkon mjetin keq, dikush tjetër thotë edhe një fjalë në adresë të punonjësve të policisë që nuk janë normale. Ne hasemi me shumë problematika me njerëzit sepse puna jonë ajo është ne më shumë na lidh puna me njerëz problematikë, që kanë qejf ta shkelin rregullin, ta shkelin ligjin pastaj ndikimet janë nga më të ndryshmet. Një problem tjetër ju e diskutuat këtu dhe e thatë që janë rrjetet sociale, kjo është pjesa e padukshme që edhe familja edhe prindi edhe ne nuk e dimë se me kë komunikon fëmija, me kë komunikon çfarë problemesh trajton, çfarë situatash kanë, kanë lidhjet e veta shoqërore nuk kemi mundësi t'i ndjekim nëpër këta rrjete. Se manifestojnë edhe veprime që përbëjnë edhe dhunë, paraqesin edhe mjete që janë të kundraligjshme, që me atë mund të realizojnë edhe krimin, siç ishte rasti konkret nesër prap këtu del detyrë që ne të rrijmë edhe më afër si prindër. Për sa i përket bashkëpunimit në shkolla ne thuajse çdo ditë këtu në Rrogozhinë kemi thuajse çdo ditë takime me përfaqësuesit e shkollave deri tani nuk na është prezent një problematikë për prishjen e rregullit në shkollë që përbën elementë të veprës penale që ne ta trajtojmë atë sipas kodit penal, sipas kodit të procedurës penale, që personat përgjegjës përderisa janë ezauruar të gjitha hapat e tjera të përgjigjen edhe para ligjit nuk është ndonjë gjë. Ligji për këtë është dmth ka dhe karakter edukues, edukimi nëpërmjet dënimit që ka sanksionuar ligji nuk është se kam qejf unë ose kam dëshirë unë. Kështu që në këtë aspekt unë kam me këtë të shkolave se këtu po bëhet fjalë, këta ruajnë shumë rezerva të brendshme nuk i bëjnë prezent problematikat, e kanë më dëshirë që t'i bëjnë problem nëpër kafe nëpër lidhjet e tyre shoqërore se sa t'i bëjnë me ne kur është problem që duhet ta ndjekim ne si polici. T'i bëjnë me një institucion tjetër që duhet ta ndjelki ai dhe të gjitha këto shkojnë në atë drejtim që të parandalojmë, të parandalojmë një rast dhune në shkollë, një rast kriminal që mund të ndodhi me fëmijët, jo vetëm brenda ambienteve por dhe jashtë ambienteve, ama këtë e bën mësuesi e bën familja, e bëjmë që të gjithë por duke ditur që personat problematikë që me të vertetë krijojnë shqetësime në shkollë në qoftë se i duhet ndihma jonë si polici ta kërkojnë ne jemi gati ta japim jashtë ambienteve të shkollës por detyra është që këta t'i kontrollojnë vetë fëmijët kur futen në shkollë. Fëmija në shkollë duhet të vijë se të gjithë



kemi qenë në shkollë kemi fëmijë, duhet të vijë me çantën, me librat me të gjithë mjetet shkollore që i takon nuk ka pse rri në shkollë një fëmijë që mund të marri thikë me vete, mund të marri mjet të fortë, mund të marri diçka që rrezikon edhe jetën e tjetrit por i bën dëm edhe vetes. Sepse moshë atyre është në atë fazë që ato nuk e kuptojnë veprimin që bëjnë, ato mund të krenohen me një veprim që mund të bëjnë se mund të jenë më të fortë, mund të jenë më të zotë se të tjerët por e keqja përqafohet më shpejt edhe këtu në këtë aspekt duhet të bëhet edukimi që ka vite që tek ne çalon. Çalon në kuptimin sepse unë shikoj se unë kam vetë 3 fëmijë deri tani nuk më kanë sjellë ndonjë shqetësim i kam rritur në moshë madhore por shikoj në shumë mësues kur shkoja unë se unë në Durrës rri dhe është parë që thotë fëmija jot është problem që më prish orën e mësimit. Si mund të thotë një mësues fëmija prish orën e mësimit? Ku është telefoni që ke prindin ti?! Merr telefonin vi unë aty. Po ka dhe nga ata mësues që bien në siklet i shkon prindi thotë kush je ti që dhunon fëmijën tim?! Po them kam raste unë këtu 2-3 herë ka shkuar një fëmijë që e kanë në shkollë të mesme ato kemi çuar dhe veprime ndjekje penale janë akoma veprime në prokurori. Mu drejtua mua më tha ti më ke dhunuar disa herë mua. Pse çfarë dhune ka këtu? Po ja më ke thënë që mos bëj këtë veprim. Unë të kam këshilluar more djalë nuk të kam dhunuar. Ne i njohim edhe shumë persona që mund të sjellin problematika, i kemi në mbikqyrje por ata janë nën moshë baza duhet të jetë edukimi, edukimi familje, shkollë, shoqëri. Të gjithë duhet të vihem para kësaj të keqeje ta parandalojmë nuk kemi pasur deri tani raste por nuk do të thotë që ne duhet ta nënvlerësojmë mund të kemi nesër, ishallah sdo kemi asnjëherë. Por puna jonë duhet bërë që ne të mos kemi asnjëherë, ju them një rast sa për ta ditur sot, një zyrtar i lartë është e vërtetë çfarë diskutojnë këshilltarët këtu më ka lënë shumë në indinjatë shumë të prekur në një komunikim që ka bërë me punonjësit e policisë. Ore jemi njerëz jemi familjarë jemi të gjithë plus kësaj ti je drejtues i një institucioni si mund të reagosh ti kur punonjësi i policisë ndëshkon një shkelës për një parkim të gabuar. Ti thuash këta maskarenj vejnë gjobë! Po kush je ti? Shiko ku kemi arritur ne kemi dalë nga ajo... edhe ne që kemi pjekurinë kemi arsimin kemi shkollën, kemi përvojën kemi rritur fëmijë në një moment shfaqen këto raste. Po them që ne duhet t'i thërrasim arsyet, të zbatojmë rregullat kudo që jemi, të kërkojmë llogari si përfaqësues institucioneve atje ku jemi me njerëzit që kemi atje ku na shkon fjala kjo është ajo që ne mund të parandalojmë dhe të mos kemi sjellje kriminale. Kjo është unë nuk di të them ndonjë gjë tjetër po ka ndonjë vërejtje sugjerim më thoni unë do ta mbaj shënim edhe ne do mundësojmë punën tonë. Nuk ka punë që të mos ketë mangësi, e keqja është kur ata i bën qëllimisht, i bën me dashamirësinë e keqe. Kush ka ndonjë sugjerim për të na thënë.

Mukades Gixhari . Po z. Isa Halili.

Isa Halili . Atëherë unë e dëgjova me shumë interes z. Haki Met-hasa jam plotësisht dakord me çdo gjë që ai tha ishte shumë i logjikshëm me atë që tha. Por ndër të tjera konstatoi atë që ne



e ngritëm si problematikë të madhe. E para e citoi dhe e tha fare mirë që ajo që ndodh në shkollë ne nuk vjen informacioni i plotë për problematikën që ka atje dhe këtu bien të gjithë hallkat që kanë të bëjnë me arsimin në Rrogozhinë. Dhe e dyta me të drejtë dhe këtu është një problem shumë i madh për secilin prej nesh kur uniforma jonë e policisë ka rënë sepse ofendohemi se po bëjmë detyrën dhe ajo që unë konstatoj dhe më e frikshmeja e gjithë kësaj historie është fakti kur një polic në detyrë këta njerëz kanë guximin e intimidojnë e shajnë çfarë ndodh me të tjerët që janë qytetarë të thjeshtë në këtë vend ky është problemi më i madh. Dhe ajo që kërkoj insistoj që duhet bërë menjëherë siguria është parimore është çfarë plan masash do merren për këtë situatë që nuk ka të bëjë vetëm me nxënësit e shkollës. Këtë rast ishte çështja e arsimit djalit 14-vjeçar por në tërësi për të gjithë moshat dhe e dyta është dhe pyetja që unë kam është. A ka një listë të detajuar të njerëzve të cilët prishin rendin dhe qetësinë publike në qytet dhe çfarë masash merren për këta njerëz sepse sipas konstatimit që unë kam personat të cilët nuk kanë mbushur 18-vjeç , çfarë do që ato bëjnë pra që mund të intimidojnë mund të shajnë mund të fyejnë mund të vrasin persona të tjerë në qytet, shkojnë në komisariat japin deklaratë dhe dalin thonë nuk i kap ligji do merret një instancë apo një tjetër. Pra këta janë njerëz rrezik konstant për gjithësecilin prej nesh me apo pa të drejtën e tyre. Ka shkuar situata deri në atë pikë ku thuhet çfarë ke që më shikon? E drejtë legjitime e çdo qenieje njerëzore sepse ka sy. Çfarë ke që më shikon? Pra e keni kthyer vite pas në mendësi dhe e frikshme nuk është detyra e tyre ndoshta instanca më të mëdhaja por dhe situata sigurisht ndikon familja dhe gjithësecili prej nesh është fakti pse kjo mendësi po rritet frikshëm dhe pse policia e shtetit po e humb reputacionin që duhet të kishte unë kam qenë nxënës para 7 vitesh kam qenë në gjimnaz po në këtë vend në këtë Rrogozhinë është e drejtë ajo që tha Enveri u kontrollonin detajet më të vogla. Mësuesi kishte fuqinë të kërkonte llogaridhënie për arsimin dhe me të drejtë merrte prindin tim apo të një shoku apo të një shoqeje timen dhe thonte ka rënie në arsim nuk u bënte fjalë në mënyrë kategorike sjellja, që ishte gjëja më parimore bazike e mundshme.

Mukades Gixhari . Z. Isa të falenderoj.

Silvana Aliu . E falenderoj shefin e policisë dhe desha t'i drejtohem, i nderuar ju jeni hallka e fundit e problemit për sa i përket shkollës deri tani duke qenë tek shkolla "Qamil Gjuzi" nuk kemi pasur problematika dhe nuk kemi pse t'i mbajmë të fshehura. Në qoftë se unë do ta sjell një nxënës tek ty i bie që unë si mësues kam dështuar sepse nuk arrita ta edukoj... nuk kam pasur raste që ne ta bëjmë kaq të madhe.

Indrit Dedej . Mund të ndodhi rast Silvana.

Silvana Aliu . Në shkollat tona jo njëherë...



Indrit Dedej . Nuk është për të thënë që dështon mësuesi për një fëmijë që...

Haki Met-hasa . Më fal që po të ndërpres dua ta bëjë prezent një rast që ka qenë në një shkollë këtu që na kanë sjellë me shkresë problematikën që kanë konstatuar në rrjetet sociale ku janë bullizuar nxënësit janë sharë edhe mësuesit edhe të gjithë i kemi kërkuar jo një herë por disa herë me insistim, ta dëgjojë dhe drejtoresha e arsimit këtu edhe kanë evituar që të ndjekim rrugën ligjore ta ndjekim ligjërisht këtë gjë. Kjo për mua nuk më duket e drejtë i kemi vënë dhe mjete në dispozicion dhe të gjitha thoni ta ndjekim ligjërisht, janë mjaftuar që ajo adresë është mbyllur nuk po kemi shqetësime më. Mirë puna e tyre sepse kallëzimi është individual do e bën. Por kjo mund të shkojë deri atje si rasti konkret që ne nuk i dimë si marrim vesh dhe shkon në ngjarje pastaj. Sa vlen që të iki jeta e një personi kur ne kemi mundësi edhe ta bëjmë prezent ta parandalojmë në këtë aspekt e kam. Për sa i përket problemit që ngriti është e drejtë ne i kemi evidentuar të gjithë personat problematikë që sjellin shqetësime edhe për komunitetin edhe për ne si polici në qytet për ato raste ne kemi dy raste për të njëjtin person që janë materialet në prokurori atë vendimin, gjykimin nuk e bëjmë ne, ne referojmë materialet gjykohen në shkallët e gjyqësorit, pavarësisht se është moshë nën 18-vjeç. Përgjegjësia penale fillon 14-vjeç, përgjegjësia për kundërvajtjet penale fillon 16-vjeç, pra ai do gjykohet do shkojë në dënim nuk është puna që e lejmë ne. Se ne nuk mund t'i marrim njerëzit se duam për momentin keq na vjen se manifeston një veprim nuk mund t'i marrim të bëjmë si duam me ato. Ka rregulla ka ligje kur ne shikojmë që ai ka problematika që nuk përbejnë elementë të veprës penale merremi me të e intervistojmë , thërrasim prindin psikologun edhe e ndjekim siç është, punonjësi social e të gjithë. Kur ka elementë që përbejnë elementë të veprës penale ne e referojmë atë rast në prokurori, kaq është.

Mitat Daja . Takon ta mbyll unë meqë e shkruajta unë kërkesën për këto, dy fjalë apo e ka Fatmira fjalën.

Fatmira Thartori . Atëherë falenderoj përfaqësuesit e postës së policisë me përgjigjet që na dhanë dhe masat që kanë marrë konkretisht. Tek shkolla jonë në Gosë SPZ i zonës dhe punonjësit e policisë bashkiake janë të pranishëm çdo ditë. Ndërsa për sa i përket shkollave rasti që ne jemi shumë të shokuar dhe i shprehim ngushëllime familjes, ka ndodhur në shkollat 9-vjeçare. Tek gjimnazi është psikologu është oficeri i sigurisë pra nuk kam gjë me policinë por e kam me institucionet e shkollës...

Indrit Dedej . Ne duam ta kesh me atë Fatmira...

Fatmira Thartori . Ndërsa për sa i përket rastit nuk kam konflikt interesi hiç fare. Unë do t'i



bëja sugjerim meqenëse drejtoresha e ZVA-së merr pjesë në konferenca apo në mbledhjet e ministrisë do të sugjeroja që edhe në shkollat 9-vjeçare të vendoset një oficer sigurie. Sepse duke filluar që nga klasa e 7-të që fillon adoleshenca e 8-ta, e 9-ta këto janë problem, pra në klasë të 10 nxënësit fillojnë edhe bien kurse nga e 7-ta, e 8-ta sidomos aty fillon lulëzimi i adoleshencës ky ishte sugjerimi im. Faleminderit.

Mitat Daja . Dy fjalë, që të mos keqkuptime se ndoshta dhe në aspektin e pozicionit që kam unë nuk flas kurrë për njerëzit kur përmenda institucionet nuk kam qëllim një person të vetëm as drejtoreshën e zyrës arsimore, as drejtoreshën e shkollës askënd. Ne flasim pra kur diskutohen çështje, diskutojmë që të rregullohen, pra duhet të ketë një marrëdhënie të mirë ndërmjet institucioneve. Se nesër është ajo pasnesër mund të jem unë, mund të jetë dikush tjetër nuk ka rëndësi, e rëndësishme është të krijohet një klimë bashkëpunuese ky është problemi më i madh që kërkohet dhe fola dhe falenderoj dhe ata që morën pjesë dhe na dëgjuan.

Indrit Dedej . Unë kisha vetëm diçka me shefin këtu meqë komandatin e kemi të ri atje bashkëpunimin nuk e di si e keni, apo nuk njiheni fare? Bashkëpunimi juaj duhet të jetë shumë i frutshëm, kështu që duhet të jetë shumë i frutshëm ky ka pjesën e vet policia e shtetit ti ke pjesën tënde.

Mukades Gixhari . Atëherë faleminderit këshilltarëve që e kërkuat këtë takim me zotërinjtë e nderuar. Faleminderit shumë që u përgjigjët me urgjencë ftesës dhe thirrjes tonë sepse jo më larg se dje ne i kemi njoftuar zotërinjtë dhe sot i kemi të gjithë në sallë. Ju faleminderit për këto fjalë dhe informacion që do na shërbejë për mbarëvajtjen e punës në vazhdim.

Haki Met-hasa . Faleminderit dhe juve kurdo tek ne jeni të mirëpritur.

Mukades Gixhari . Kemi dhe një pikë të rendit të ditës për shqyrtimin e draft të paketës fiskale për vitin 2025. Drejtoresha e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik znj. Marsida Thartori.

Mitat Daja . Por se ke përfshirë tek pika e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Po z. Enver. Është diskutim nuk është projektvendim.

Enver Memolla . Unë e kam shprehur qëndrimin tim dhe do ta shpreh edhe sot nuk ka kuptim që të mos jetë në diskutim në rend dite paketa fiskale por të jetë tek të ndryshmet. Paketa fiskale është paketë fiskale ku diskutohet tarifë familjare tarifë e bizneseve e të gjitha me radhë taksat deri ku të dalin që do thonë 13% prap u mblodhën taksa.



Mukades Gixhari . Në mbledhjen e kaluar ishte por na u larguan këshilltarët.

Enver Memolla . Nuk u diskutua se ishte po tek të ndryshmet.

Mukades Gixhari . Jo nuk u diskutua tek të ndryshmet por ikën.

Enver Memolla . Edhe mbledhjen e kaluar ta kam thënë në cilin komision është diskutuar paketa fiskale? Dhe cilët janë komisionet që kanë sjellë përgjigjet apo draftin e tyre për ndryshime apo sugjerime në paketë fiskale? Sepse në bazë të komisioneve në datë 6, apo 5 ku është ajo ...

Mukades Gixhari . Z. Enver është me datën 5 nuk do të diskutojmë tani me datë 6, me datë 5.

Enver Memolla . Me datë 5 në rregull.

Mukades Gixhari . Ta çojmë deri në fund këtë muhabet me datë 5 i kam dhënë letrat dy kryetarëve të grupeve që në mbledhjen e herës së parë. Më vjen keq tani që diskutoni akoma këtë muhabet.

Enver Memolla . Tani për sa i përket paketës fiskale nuk është diskutuar asnjëherë në këshill.

Mukades Gixhari . Dje tek mbledhja e komisionit është diskutuar kjo pjesë që jua shkruajtëm?

Enver Memolla . Është diskutuar privatisht jo me rend dite, se nuk është diskutuar asnjëherë në parim, e kemi në parim në mbledhjen e këshillit nuk ka ardhur. Tani unë sugjeroj që pas datës 5 të mbledhjes përpara se të vijë për miratim në Dhjetor paketa fiskale dhe buxheti të bëhet një mbledhje jashtë radhe në lidhje me paketën fiskale. Është pikë strategjike e buxhetit sepse në bazë të saj varet buxheti i bashkisë në këtë lloj historie. Të mos e bëjmë gjelin në tepsi dhe ne këtu të ngrejmë dorën të ikim, se na vijnë ne siç na ndodhi vjet se harroj atë të vjetshmen që vinin njerëzit nga bashkia i ka sjellë këshilli, që mos ta bëjë këshilli këtë radhë ta bëjmë më mirë ligjore të mblidhemi dy herë pa problem për paketën fiskale por t'i vejmë pikat mbi "i" tek paketa fiskale mos ketë drejtim gishti. Faleminderit.

Mukades Gixhari . Jeni dakord me çfarë tha z. Enver?

Mitat Daja . Po sigurisht nuk mund të përfshish paketa fiskale tek të ndryshmet sikur është gjëja më e thjeshtë e mundshme një diskutim i thjeshtë.



Altin Tosku . Ajo duhet të jetë çështje ditore vetëm ajo pjesë.

Mitat Daja . Është baza e buxhetit 2025 si mund të bëhet pa kaluar komisionet, pa kaluar asgjë.

Mukades Gixhari . Ndonjë gjë tjetër që ju ka ngelur merak ta diskutojmë. Po znj. Alime.

Alime Hoxha . Unë doja në fakt tek të ndryshmet se nuk po shikoj më njeri këtu nga shërbimet e bashkisë drejtorat e bashkisë gjithsesi Vis mbaji shënim edhe të jenë aty disa kërkesa që kanë të bëjnë me shkollat.

Enver Memolla . Drejtoja me shkrim sekretarit të ja protokollojë të ja çojë.

Alime Hoxha . Është furnizimi i shkollave me dru, detergjentë dhe materiale të tjerë siç janë bojërat e printerit, letër...

Elton Xhani . Zysh më fal të shtoj diçka meqenëse nuk është Vali, në dijeninë time ka filluar se dje se sot shpërndarja e druve.

Alime Hoxha . Përveç druve janë dhe detergjentët. Një gjë tjetër nëpër shkolla janë vendosur bombula për fikjen e zjarrit por që ato duhet të mbushen çdo 6-të muaj dhe në dijeninë time nuk janë mbushur, pra duhet të rregullohen. Tek shkollat që janë buzë rruge, shkollat e fshatrave Zhabjak, Vilë, Ballaj, Spille ka një propozim për vendosjen e atij policit të shtrirë përpara shkollës sepse ecin makinat me shumë shpejtësi.

Indrit Dedej . Ku iku ai polici, ishte këtu ai polici?

Altin Tosku . Ikën direkt ato mbaruan dhe ikën.

Erind Tosku . Jo polici bashkiak, polici ai që rri shtrirë.

Alime Hoxha . Bazën materiale dhe nuk e di këtu është dhe Erindi për internetin tek shkolla “Qamil Gjuzi”, bashkia kush e ka.

Enver Memolla . Një sekondë më fal se harrova diçka, ju bëj me dije me Elton Xhanin e kam ...

Alime Hoxha . Kisha dhe ca të tjera meqë nuk ka njeri këtu nuk po i ngrej më.



Enver Memolla . Meqenëse ishte bërë një barcaletë që kanali i Verit ai kanali i “Zogut” dua një raportim sot çfarë ka ndodhur dhe si ishte nga drejtoria e bujqësisë?

Elton Xhani . Siç i dhamë fjalën këshilltarit z. Enver Memolla realizuam pastrimin e këtij kanali ishte vërtet gjëndje alarmante ekstreme dhe 200 m kanë ngelur.

Indrit Dedej . Z. drejtor pse i bëni punët pa plan?

Enver Memolla . Pyetja ishte si ishte, çfarë ishte?

Elton Xhani . Ishte me të vërtetë gjëndje alarmante.

Indrit Dedej . Auditi i brendshëm tha katastrofë, ti nuk mban asnjë lloj dokumentacioni.

Mukades Gixhari . Z. Altin Tosku ka diçka për të thënë se kemi dëgjuar sot fare. Po z. Altin.

Altin Tosku . Nga rreth rrotullimi i Teqes deri tek ura e Shkumbinit është ajo rruga që është blozë komplot.

Elton Xhani . Ai është kanali i ujërave të zeza dhe sa të mbarojmë atë...

Altin Tosku . Aty nuk kalon ka vite e vite, tani ajo është bërë rrugë kryesore është rregulluar rruga nga matanë Thanasjes deri këtej që kalojnë shumë makina aty tani një makinë me zor nuk shkëmbehen dot dy prej kanalit dhe prej tubave të Petritit i themi ne, se Petriti e ka bllokuar me tuba.

Elton Xhani . Për pjesën e tubave nuk është kompetencë...

Mitat Daja . Po mirë pra drejtoritë që janë përkatëse Policia Bashkiake, IMTV-ja.

Altin Tosku . Jam dakord unë ti do pastrosh kanalin por pa hequr tubat nuk pastrohet kanali, po kap një por është dhe pjesa tjetër, prap tek Teqja ballë për ballë Teqes janë vënë paletat prap po e njëjta gjë është, po nuk u hoqën ato nuk pastrohet kanali.

Elton Xhani . Sa të përfundoi kanali i Zogut pika e dytë që kemi plan për të realizuar është ai kanali sepse ka dhe ujërat e zeza që vijnë nga pjesa lart kalojnë drejtë në grykëderdhje të Shkumbinit.



Indrit Dedej . Kryetare kam një kërkesë këtu live që po na ndjek njëri nga Italia nga fshati Sinaballaj as nuk e njoh thotë fshati jonë Sinaballaj, ai thotë kam tre pyetje. Një pastrimi i përroit Sinaballaj, dritat e fshatit, hyrja e fshatit të zgjerohet dhe ju përshëndes nga Bolonja.

Mukades Gixhari . Faleminderit.

Elton Xhani . I lexova pak më parë tani për përroit është tepër i thellë e tepër i gjatë që edhe skrepi që kemi...

Altin Tosku . Sa herë është bërë premtim nga fshati.

Elton Xhani . Unë nuk kam bërë premtim.

Mitat Daja . Po mirë Bashkia mban përgjegjësi për këtë punë.

Indrit Dedej . Çoji të fala eprorëve të tu, i vetmi investim që ka bërë Bashkia për investimin e fshatit Sinaballaj mos bëjnë gabim ta djegin sepse për atë Zot po betohem para të gjithëve nuk jam frikacak unë do ju çoj në prokurori, ta keni të qartë. Jo premtim e ka bërë investim për kanal me tuba ku di unë e ka bërë investim, dmth e ka ndarë buxhetin që kaloi dhe e mbajnë kastile në sirtar. Unë të betohem për atë Zot është për rrugë fshati e ka dhënë buxheti, ka një vit që e mbajnë në sirtar, se duan ta rrujnë dhe atë çikë.

Elton Xhani . Ta ripërsëris edhe njëherë i vetmi premtim që unë kam dhënë këtu në këshill ka qenë kanali i Zogut.

Indrit Dedej . Nuk po them ti, m'i bëjë të fala eprorëve, ta diskutoni se për atë Zot i kam gati letrat për në prokurori nuk ju haj në besë po jua them këtu.

Alime Hoxha . Edhe një gjë kryetare. Meqenëse po dalim tek këto që thotë Indriti, ne duam një relacion nga Bashkia. Sa projektvendime nga ato që ne kemi miratuar janë zbatuar dhe sa janë në proces zbatimi dhe sa ka pa zbatuar akoma.

Mukades Gixhari . Atëherë meqë nuk kemi diskutime mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 00^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati rreth 01 orë ; 49 min ; 58 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 37 (tridhjetë e shtatë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

**Sekretari i Këshillit
Ervis Shera**